



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENO DANA:		23.07.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
05	453/01	34248	



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan: 23.07.2026

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Për financimin e projekteve të klubeve sportive në fushën e sportit për kategorinë e seniorëve për viti 2026

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 08/L - 277 neni 44 pika 1.4** për Sportin, **Ligjit Nr. 06/L-043 neni 36** për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, si dhe Rregullores së Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të Organizatave Joqeveritare, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall këtë:

THIRRJE PUBLIKE

Për mbështetjen financiare të projekteve të klubeve Sportive që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Lipjanit.

1. Synimi i thirrjes

Synimi i kësaj thirrjeje është mbështetja financiare e klubeve sportive të kategorisë së seniorëve për pjesëmarrje në gara për federatën përkatëse, përmirësimin e kushteve të funksionimit dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive.

2. Fusha prioritare

Projektet duhet të kontribuojnë në realizimin e prioritetit:

“Sporti - Mundësi për të Gjithë në Komunën e Lipjanit”.

3. Fondi i thirrjes

Fondi i përgjithshëm i planifikuar për këtë thirrje është: **75,000.00 euro**

Mjetet financohen nga: **Subvencione dhe transfere.**

Shuma minimale e grantit: **501.00 euro**

Shuma maksimale e grantit: **10,000.00 euro**

4. Periudha e zbatimit

Projektet duhet të realizohen brenda **6 muajve** nga data e nënshkrimit të kontratës.

5. Shpenzimet e pranueshme

Mbështetja financiare mund të përdoret vetëm për:

- 1.Pagesën e referëve për ndeshjet zyrtare.
- 2.Transportin për ndeshjet zyrtare (me përjashtim të derivateve).
- 3.Ushqimin gjatë ndeshjeve zyrtare.
- 4.Regjistrimin dhe kuotizimet në federatat sportive.
- 5.Blerjen e pajisjeve dhe rekuizitave sportive.
- 6.Shpenzimet për ekipin mjekësor gjatë ndeshjeve zyrtare.

6. Shpenzimet e papranueshme

Nuk financohen:

Pagesat e borxheve.

Gjobat dhe penalitetet.

Kamatat bankare.

Shpenzimet personale që nuk lidhen me projektin.

Investimet kapitale.

Blerja e automjeteve.

Derivatet e karburantit.

Aktivitetet me karakter politik ose fetar.

7. Kush ka të drejtë të aplikojë-

Të drejtë aplikimi kanë:

Klubet sportive (vetëm ekipet kategorisë së seniorëve), të cilat:

Janë të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi.

Zhvillojnë veprimtarinë në Komunën e Lipjanit.

Marrin pjesë me ekipin senior në gara zyrtare të federatave përkatëse.

Kanë program të punës në fushën e sportit.

Kanë përmbushur obligimet kontraktuale ndaj Komunës së Lipjanit dhe institucioneve të tjera publike para mbylljes së thirrjes publike.

Kanë menaxhim financiar transparent.

Çdo klub sportiv mund të aplikojë vetëm me **një projekt**.

8. Vlera orientuese sipas kategorive

Klubet e Futbollit: 501 € - 10,000 €

Klubet e Volejbollit: 501 € - 10,000 €

Klubet e Hendbollit: 501 € - 4,000 €

Klubet e Ping pongut: 501 € - 2,000 €

Shuma përfundimtare do të përcaktohet nga Komisioni Vlerësues bazuar në cilësinë e projektit dhe buxhetin e disponueshëm.

9. Dokumentet që duhet të dorëzohen

Sipas Rregullores Nr. 04/2017

10. Kriteret e vlerësimit

Projektet do të vlerësohen sipas:
Përputhshmërisë me objektivat e thirrjes.
Kapacitetit organizativ.
Cilësisë së projektit.
Ndikimit në komunitet.
Arsyeshmërisë së buxhetit.

11. Afati i aplikimit

Afati për dorëzimin e aplikimeve është **15 ditë pune** nga data e publikimit të kësaj thirrjeje.
Aplikimet e dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

12. Mënyra e dorëzimit

Aplikimet dorëzohen vetëm në formularët zyrtarë të Komunës së Lipjanit.
Dokumentacioni dorëzohet personalisht në:

Komuna e Lipjanit

Zyra për Shërbim me Qytetarë

Rruga "Shqipëria", Lipjan

13. Procedura e vlerësimit

Pas mbylljes së afatit:
Bëhet kontrolli administrative.
Komisioni vlerëson projektet.
Publikohet lista preliminare.
Shqyrtohen ankesat.
Publikohet lista përfundimtare.
Nënshkruhen kontratat me përfituesit.

14. Informata shpeshë

Pyetjet lidhur me këtë thirrje mund të dërgohen vetëm në adresën elektronike:

uran.qeriqi@rks-gov.net

Vetëm pyetjet e pranuar brenda afatit të përcaktuar do të marrin përgjigje.

15. Dispozita përfundimtare

Pranimi, hapja, shqyrtimi, vlerësimi, kontraktimi, monitorimi dhe raportimi i projekteve do të zhvillohen në përputhje me Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Astrit Buja

Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport
Komuna e Lipjanit

